



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, më 13.2.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik Darjel Sina, në seancën publike të datës 13.2.2019, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kundër vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari, prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues!

Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e procesit të rivlerësimit, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar Komisioni), pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar Kolegji), bazuar në nenin C, pika 2, dhe F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës.

Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, neneve 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë në marrjen e provave.

Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

Edhe në rastin konkret, nga shqyrtimi i vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, i Komisionit dhe provave të administruara për këtë qëllim, Komisioneri Publik, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atij profesional, çmon se hetimi administrativ nga ana e Komisionit nuk është i plotë dhe ka mangësi.

Në këto kushte, bazuar në nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, në vijim paraqesim vlerësimin dhe shkaqet e ankimit, si dhe nevojën e hetimit të mëtejshëm nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

VLERËSIMI DHE KËRKIMET E KOMISIONERIT PUBLIK

A. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë

Në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë “Vetting” (më datë ***.1.2017), bashkëlidhur dokumentacionin mbështetës. Nga krahasimi i kësaj deklarate me deklaratat periodike të pasurisë, referuar nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ndër të tjera subjekti rezulton se ka deklaruar:

- I. **Pasuria** (1) Tokë-arë me sip. 350 m² dhe shtëpi banimi (4 kate), ndodhur në Tiranë.
 - Në Deklaratën “Vetting”, subjekti deklaron: Tokë-arë, me sipërfaqe 350 m², në bashkëpronësi të personit të lidhur/bashkëshortit z. ***.***, vëllait të tij (***.***), dhe nipit të bashkëshortit të subjektit (***.***), në vlerën 700.000 lekë, blerë në vitin 2001. Pjesa takuese për 1/3 e pasurisë, në bashkëpronësi me bashkëshortin.
Burimi i krijimit: kursimet familjare të bashkëshortit, të krijuara kryesisht nga puna si emigrant në Greqi, në vitet 1997-2000.
Shtëpi banimi, e ndërtuar në mënyrë informale mbi tokën e sipërcituar, gjatë viteve 2001-2002. Vlera e shpenzuar për ndërtimin e pjesës zotëruese, për 1/3, është 3.000.000 lekë.
Burimi i krijimit: nuk deklarohet.
 - Në deklaratën vjetore të vitit 2003 (dorëzuar në mars të 2004) pasuria tokë-arë, deklarohet në vlerën 1.400.000 lekë¹ me pjesë takuese 50%.
Burimi i krijimit, deklarohen të ardhurat familjare dhe emigracioni i bashkëshortit.
Shtëpia e banimit, ndërtuar mbi tokën-arë, deklarohet me sipërfaqe 140 m² dhe me vlerë 3 milionë lekë, me pjesë takuese 25%.
Për burimin e krijimit, deklarohet “e ndërtuar vetë, me të ardhura familjare, emigracioni i bashkëshortit”.

Lidhur me burimin e krijimit të banesës, gjatë hetimit administrativ të Komisionit², subjekti ka deklaruar se të ardhurat kanë qenë ato të përmendura për tokën-arë, pra të ardhurat familjare të familjes së bashkëshortit dhe të ardhurat nga emigracioni i këtij të fundit, dhe ka përfshirë gjithashtu dhe të ardhurat e bashkëshortit nga puna si gjeodet në Arabinë Saudite, në vitin 2003, për 5 muaj, në shumën 12.000 euro, nga shoqëria “****” sh.p.k.

¹ Vlerë kjo e deklaruar më datë ***.11.2006, referuar akteve në ILDKPKI (DV-2003 mban shënim këtë datë gjithashtu në seksionin ku deklarohet kjo pasuri).

² Referohuni pyetësorit të datës ***.2.2018.

Sipas deklaratës vjetore për vitin 2003 (dorëzuar në mars të 2004), të ardhurat e bashkëshortit deklarohen 310.000 lekë (deklaruar 0.31 milion lekë neto), nga puna pranë shoqërisë “***”. Gjithashtu, në deklaratën vjetore për vitin 2004 dhe 2005, të ardhurat e bashkëshortit deklarohen ato vjetore nga paga, përkatësisht në shumën 400.000 lekë.

Përfundimet e Komisionit

Me gjithë kontradiktat dhe pasaktësitë në deklarinimin e krijimit të pasurisë, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka vlerësuar se: “...*përputhen deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit. Për këtë pasuri, znj. Sevdari ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion, i cili e ka bindur trupin gjykues lidhur me krijimin e kësaj pasurie, herët në vitet 2000-2002, nga bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij...*”³.

KONSTATIMET DHE KËRKIMI

Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje për këtë pasuri, konstaton se:

- *Për burimin e ligjshëm të të ardhurave, të deklaruara nga emigracioni* i personit të lidhur/bashkëshortit, gjatë viteve 1997-2000⁴, Komisioni ka administruar vetëm tri dokumente të lëshuara nga Instituti Grek i Sigurimeve Shoqërore, të cilat vërtetojnë blerje pullash sigurimi shoqëror për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 1998. Këto akte nuk provojnë nëse ato lidhen me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, ato figurojnë vetëm për një periudhë tremujore punësimi dhe jo për periudhën trevjeçare të deklaruar nga subjekti.

Referuar pikës 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së⁵, deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklarinimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë.

Në këtë kontekst, Komisioni nuk ka hetuar dhe analizuar asnjë fakt tjetër për periudhën 3-vjeçare të pretenduar të punësimit të personit të lidhur, si emigrant në shtetin grek (1997-2000), si për shembull: punën e kryer, punëdhënësin, shpenzimet e jetesës dhe kursimin pas pagimit të detyrimeve tatimore, me qëllim arritjen e konkluzionit nëse të ardhurat e siguruara gjatë kësaj

³ Referohuni f. 6 të vendimit të Komisionit.

⁴ Rezulton se znj. Sevdari, së bashku me bashkëshortin e saj kanë lidhur martesë ligjore në mars të vitit 2001 (referuar pyetësorit të KPK-së, së datës ***.2.2018) dhe subjekti i rivlerësimit është emëruar prokurorë në tetor të vitit 2002. Pasuria truell është blerë në korrik të vitit 2001 dhe banesa e tyre, në vlerën 3.000.000 lekë, dhe mobilimi, në vlerën 3.000-4.000, euro i përket periudhës 2001-2003 (referuar deklarinimit të vetë subjektit gjatë hetimit administrativ të KPK-së).

⁵ “Për mënyrën e deklarinimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

periudhe në emigracion do të konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

- *Për burimin e ligjshëm të shumës 12.000 euro*, konstatojmë se subjekti ka paraqitur një deklaratë nga shoqëria “****” sh.p.k., e datës ****.1.2017*, ku administratori i kësaj shoqërie deklaroi se bashkëshorti i subjektit, z.***.***, për periudhën qershor-dhjetor 2003 ka punuar në Arabinë Saudite dhe është paguar nga kjo kompani në shumën 12.000 euro brenda vitit kalendarik 2003. Ndërsa në përgjigjen e dytë⁶, kjo shoqëri pranon se nuk disponon asnjë kontratë punësimi, si shkak i kohës së gjatë që ka kaluar.

Referuar hetimit të kryer nga Komisioni dhe dokumentacionit të administruar, nuk gjendet asnjë e dhënë mbi mënyrën se si është kryer kjo pagesë dhe nëse për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore, për t’i konsideruar ato si atë ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Vlen të theksohet se nga analiza financiare dhe verifikimi i të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, Komisioneri Publik konstaton se për periudhën 2000-2003, në të cilën subjekti deklaroi se ka qarkulluar 3.000.000 lekë, për krijimin e 1/3 të pasurisë, dhe 3.000 deri në 4.000 euro për mobilim, të ardhurat e ligjshme nuk i mbulojnë këto shpenzime të deklaruara. Të ardhurat e ligjshme në këtë periudhë, vërtetuar me dokumentacion ligjor provues⁷, rezultojnë në shumën 1.869.447 lekë.

➤ Sa më sipër, bazuar në kërkesat e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016,

Komisioneri Publik kërkon nga ana e Kolegjit të nderuar:

1. Të riçelë hetimin administrativ, me qëllim administrimin e dokumentacionit ligjor provues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, truall + banesë. Në këtë drejtim, me vlerë konsiderojmë administrimin e dokumentacionit provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si të (i) ardhura nga emigracioni i bashkëshortit për periudhën 1997-2000 dhe (ii) puna e tij në Arabinë Saudite në vitin 2003.
2. Në varësi të hetimit administrativ mbi burimin e ligjshëm për këto të ardhura, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit t’i kalojë barra e provës për të provuar të kundërtën, pra për periudhën 2000-2003, subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të mbuluar shumën e deklaruar prej 3.000.000 lekë për krijimin e 1/3 të pasurisë dhe 3.000 - 4.000 euro për mobilimin e banesës.

II. Pasuria (2), apartamenti me sip. 101 m², ndodhur në Tiranë.

- **Në Deklaratën “Vetting”**, subjekti ndër të tjera deklaroi: apartament me sipërfaqe 101 m² (12 m² ambiente të përbashkëta) në emër të bashkëshortit, ***.***, ...Blerë në vitin 2011 sipas kontratës me nr. *** prot. /*** kol., datë ***.9.2011, me vlerë 97.500 euro.

⁶ Protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë ***.1.2018.

⁷ Vërtetim i datës ***.10.2016, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; vërtetim nr. ***, datë ***.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës, si dhe bazuar në listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k.

Burimi i krijimit: Të ardhurat e krijuara, kursime familjare të krijuara kryesisht nga pagat dhe fitimi i bashkëshortit si person fizik, inxhinier gjeodet. Pjesa takuese 100% (subjekti dhe bashkëshorti).

- Në deklaratën e interesave vjetorë të vitit 2011, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: apartament me sipërfaqe 101 m² (12 m² ambiente të përbashkëta) ...blerë sipas kontratës me nr.*** prot. /*** kol., datë ***.9.2011, me vlerë 97.500 euro⁸. Burimi i krijimit nuk deklarohet.

Përfundimet e Komisionit

Lidhur me burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka konkluduar se subjekti së bashku me bashkëshortin e saj kanë pasur të ardhura për blerjen e kësaj pasurie. Përputhen deklaratimet e subjektit me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

KONSTATIMET DHE KËRKIMI

Komisioneri Publik nuk pajtohet me përfundimet e Komisionit mbi këtë pasuri, pasi është rrjedhojë e një hetimi të mangët dhe mosvlerësimi objektiv në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

Mbi të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit si person fizik, dokumentacioni i përcjellë për këtë qëllim nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT), për vitin 2010, që rezulton në shumën 3.171.510 lekë, është kontradiktor. Ky fakt **pamundëson** arritjen e një vlerësimi objektiv në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për t'i konsideruar ato si të ardhura të ligjshme.

Dokumentacioni mbi veprimtarinë ekonomike të realizuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për periudhën gusht-dhjetor 2010, konsiston në:

- (i) Shkresën, kthim përgjigje nr. *** prot., datë ***.11.2016, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT), ndaj kërkesës të bashkëshortit të subjektit, tatimpagues me NIPT ***, ku DRTT-ja shprehet se për vitin 2010 është realizuar, fitim pas tatimit, shuma 3.171.510 lekë;
- (ii) Shkresat nr. *** prot., datë ***.8.2017 dhe nr. *** prot., datë ***.8.2017, të DRTT-së, drejtuar ILDKPKI-së, ku për të njëjtin subjekt tatimpagues (NIPT ***), shprehet se **për vitin 2010 nuk ka të dhëna në sistem**, arsye kjo për të cilën ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2017, drejtuar Komisionit, shprehet se: *“nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga fitimi i aktivitetit si person fizik të z. ***.***, deklaruar në vitin 2010”*.
- (iii) Shkresa nr.*** prot., datë ***.4.2018, e DRTT-së, drejtuar Komisionit, në të cilën shprehet se: *“të dhënat janë nxjerrë nga pasqyrat financiare të dorëzuara në arshivë, në datë ***.1.2016, me nr. *** prot....”*. Referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga vetë

⁸ Referuar vërtetimit hipotekor, prona është regjistruar më datë ***.9.2011, në regjistrin hipotekor me nr.***, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

subjekti tatimpagues në vitin 2016, për vitin ushtrimor 2010, deklaroi fitim neto shumë 3.172.699.9 lekë.

- (iv) Ndërkohë, nga nxjerrja e llogarisë bankare të personit fizik z. ***.*** nga *** Bank, rezultoi një pagesë e kryer në datë ***.3.2011, në shumë 335.148 lekë, me përshkrim “*tatim fitimi i biznesit të vogël*”. Por nuk është e qartë si është kryer pagesa e tatim-fitimit të vitit 2010, kur pasqyrat financiare të këtij viti janë dorëzuar në vitin 2016! Me çfarë dokumenti është kryer kjo pagesë?!

Në vlerësim të këtyre provave, gjykojmë se analiza financiare e Komisionit për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë është kryer bazuar në përgjigje me përmbajtje të ndryshme dhe kontradiktore të administratës tatimore. Në këto kushte është e paqartë dhe jo bindëse, pse Komisioni ka marrë për bazë shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën kjo e fundit referon fitimin neto të vetëdeklaruar në pasqyrat financiare për vitin 2010, por të dorëzuar nga subjekti tatimpagues në vitin 2016, dhe jo shkresën e kësaj të fundit, administruar nga ILDKPKI-ja, ku për të njëjtin subjekt tatimpagues rezultoi se nuk ka të dhëna në sistem.

➤ Sa më sipër, **Komisioneri Publik kërkoi nga ana e Kolegjit të nderuar:**

1. Të riçelë hetimin administrativ mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, pasi nisur nga përgjigjet kontradiktore të administratës tatimore mbi të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, e vlerësojmë të rëndësishëm hetimin dhe administrimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, informacionin e plotë për situatën financiare të bashkëshortit të subjektit, si fitimin neto dhe pagimin e tatim-fitimit¹⁰. Administrimi i këtij dokumentacioni do të mundësonte vlerësimin me saktësi mbi xhiron, pagimin e detyrimeve tatimore dhe fitimin e realizuar nga personi i lidhur, subjekti tatimpagues, duke mundësuar kështu një analizë financiare objektive rreth burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë në vitin 2011.
2. Të administrohet nga *** Bank praktika shoqëruese, me të cilën provohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer pagesën në datë ***.3.2011, në shumë 335.148 lekë, me përshkrim “*tatim fitimi i biznesit të vogël*”, pasi siç rezultoi dhe nga shkresa e DRTT-së, sistemi nuk ka gjeneruar të dhëna mbi subjektin tatimpagues për këtë vit. Subjekti për të kryer pagesën e tatim-fitimit në vitin 2011 (për vitin 2010), duhet të paraqiste një formular të deklarimit vjetor, konfirmuar nga autoritetet tatimore, bazuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor përkatës.

III. Për të ardhurat nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit në Arabinë Saudite, në shumë 18.970 USD, deklaruar në deklaratën vjetore për vitin 2006

- Në deklaratën e interesave vjetorë të 2006, subjekti ndër të tjera ka deklaruar: Llogari rrjedhëse në USD në bankën ***, çelur në muajin prill 2006. Në këtë llogari janë transferuar me transfertë

⁹ Në shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar subjektit, fitimi neto është 3.171.510 lekë, pra ka mospërputhje të shifrave të konfirmuara nga i njëjti institucion.

¹⁰ Gjate vitit ushtrimor, subjekti tatimpagues ka detyrim të mbajë dokumentacionin konform përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, sipas kreut VI, seksioni 1, “Detyrimi për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore”.

ndërkombëtare të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti si inxhinier topograf pranë shoqërisë “****”, në Arabinë Saudite. Shuma 18.970 \$.

Po në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna e bashkëshortit si inxhinier topograf, pranë shoqërisë “****”, në Arabinë Saudite, në shumën 20.000 \$.

Përfundimet e Komisionit

Për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, Komisioni ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e dhënë nga *** Bank, ku konfirmohet urdhëruesi i transfertës. *** Bank konfirmon se në datat *** prill 2006 dhe *** korrik 2006 janë kryer dy transferta, përkatësisht në shumat 9.982,97 USD dhe 9.987,26 USD, gjithsej 19.975,23 USD **dhe jo** 18.970 USD, sikundër ka deklaruar subjekti. Për këto transferta është konfirmuar edhe urdhëruesi, shtetasi italian ***.***. Ky fakt ka rezultuar i mjaftueshëm për Komisionin për t’i konsideruar si të ardhura të ligjshme.

Ndërsa ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2017, drejtuar Komisionit në lidhje me këto të ardhura shprehet se: “...nuk janë përfshirë të ardhurat në shumën 20.000 USD në Arabinë Saudite, pasi nuk shoqërohen më dokumentacion justifikues”.

KONSTATIMET DHE KËRKIMI

Komisioneri Publik vlerëson se për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave që rezultojnë me transfertë ndërkombëtare bankare nuk mjafton vetëm deklarimi i tyre dhe fakti se konfirmohet urdhëruesi i transfertës. Për t’i konsideruar këto të ardhura si të ardhura të ligjshme bazuar në pikën 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 84/2016, subjekti **duhet** të provojë dhe Komisioni **duhej** të administronte dokumentacion që ato kanë burim të ligjshëm dhe për to janë paguar detyrimet tatimore. Nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë e dhënë apo dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, rrjedhimisht ato nuk mund të konsiderohen të ligjshme, nëse subjekti i rivlerësimit nuk provon të kundërtën.

➤ Sa më sipër, referuar kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, **Komisioneri Publik kërkon nga ana e Kolegjit të nderuar:**

1. Që, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së shumës prej 19.975,23 USD, të riçelë hetimin administrativ dhe administrojë dokumentacionin e nevojshëm, nëse për këtë shumë janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Në varësi të këtij hetimi dhe vlerësimi eventual të Kolegjit, ndryshon edhe situata financiare për subjektin e rivlerësimit.

IV. Për të ardhurat e deklaruara nga veprimtaria ekonomike e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit për vitin 2016, në shumën 3.299.805 lekë

- Në deklaratën e interesave vjetorë për vitin 2016, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: Fitimi neto i personit fizik ***.***, me nipt ***, për vitin 2016, në shumën 3.299.805 lekë.

Lidhur me këto të ardhura, Komisioneri Publik konstaton se Komisioni edhe në këtë rast nuk ka hetuar lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, pasi referuar korrespondencës së Komisionit me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) vërejmë se:

- (i) DRTT-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.4.2018, drejtuar Komisionit, ka informuar se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues, për vitin 2016, është në shumën 3.299.805 lekë;
- (ii) DRTT-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ka informuar se fitimi neto i realizuar nga ky subjekt tatimpagues për vitin 2016, për NIPT-in ***, është në shumën 3.299.805 lekë, por subjekti ka detyrime tatimore të papaguara në vlerën 283,132 lekë, dhe gjithashtu detyrime të mëparshme të prapambetura dhe të palikuiduara, që i përkasin NIPT-it ***, në shumën 80.000 lekë;
- (iii) DRTT-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ka informuar se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues, për vitin 2016, është në shumën 3.299.805 lekë dhe detyrimi i subjektit deri në datë ***.8.2017, për NIPT-in ***, është 257.104 lekë;
- (iv) Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2017, shprehet se “... subjekti ***.***, me NIPT ***, nuk ka shlyer asnjë detyrim...”;
- (v) DRTT-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.1.2017, drejtuar bashkëshortit të subjektit, ka informuar se fitimi neto i realizuar nga subjekti tatimpagues, për vitin 2016, është në shumën 3.299.805 lekë, duke u shprehur se subjekti nuk është objekt i pagesës së tatimit fitimit.

➤ Sa më sipër, **Komisioneri Publik kërkon nga ana e Kolegjit të nderuar:**

Sikundër kërkuam dhe për të ardhurat e vitit 2010, me qëllim legjitimimin e tyre në kuptim të nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës, nisur nga fakti se edhe për vitin 2016 përgjigjet nga ana e administratës tatimore kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe nuk është e qartë nëse janë paguar detyrimet tatimore, Kolegji të riçelë hetimin administrativ dhe administrojë dokumentacionin provues nga ana e administratës tatimore për të vërtetuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave në vitin 2016.

B. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

Nga hetimi administrativ i Komisionit, në vlerësimin e 5 dosjeve penale të përzgjedhura, ndër të tjera ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit nr. ***, datë ***.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***.***”, vendim me të cilin subjekti është njohur dhe ka qenë prezent në seancën gjyqësore.

Nga shqyrtimi i kësaj praktike rezulton se subjekti i rivlerësimit ka humbur të drejtën e ushtrimit të ankimit brenda afateve ligjore, megjithëse ka qenë prezent në dhënien e vendimit, dhe për këtë arsye ka paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke paraqitur si shkak të mosushtrimit të së drejtës së ankimit në kohë, *pritjen e zbardhjes së vendimit dhe më pas, për arsye të rastit fator, shkaqe shëndetësore të familjarëve të saj, për të cilët duhej të kujdesej.*

Referuar nenit 43 (1) të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se, për aq sa është i zbatueshëm, procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për rastin në fjalë çmojmë se subjekti i rivlerësimit:

(i) Paraqet mungesë të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, referuar nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Mungesa e aftësive profesionale, të pranuar nga vetë subjekti lidhur me përcaktimin e saktë të rastit fator, duke cilësuar si të tillë një rrethanë krejt të ndryshme nga sa përcaktohet nga teoria e së drejtës dhe praktika gjyqësore, ka sjellë si pasojë moskryerjen e detyrës nga ana e subjektit.

(ii) Paraqet mungesë të aftësisë organizative, referuar nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të administruar dosjet gjyqësore. Kjo mungesë aftësie është reflektuar në tregues të tillë si mosrespektimi i afateve ligjore, të cilat kanë pasur efekt negativ në rezultatet e praktikës të trajtuar nga subjekti.

Gjithsesi, ky rast nuk mund të merret i shkëputur, por rezultatet nga vlerësimi i tij duhet të trajtohen në konsideratë edhe me gjetjet e mundshme nga denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit. Referuar përmbajtës së këtyre denoncimeve, ato ngrenë pretendime mbi elementet e kriterit të aftësive profesionale të subjektit dhe për të cilat nga hetimi dhe arsytimi i vendimit të Komisionit, nuk konstatojmë nëse ato janë hetuar dhe vlerësuar. Në këtë kontekst, neni Ç, pika 2, paragrafi i dytë dhe neni 53 i ligjit nr. 84/2016 lejon marrjen e informacioneve nga ana e publikut, të cilat kanë vlerë për procesin e rivlerësimit.

Komisioneri Publik konstaton se, megjithëse për subjektin janë depozituar 10 denoncime, hetimi i Komisionit për disa prej tyre ka munguar plotësisht. Referuar neneve 40 dhe 53/2¹¹ të ligjit nr.84/2016, pretendimet e denoncuesve, paraqesin rrethana, të cilat referojnë se subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në kriterin e aftësive profesionale, shkak i cili duhej të detyronte Komisionin të hetonte dhe vlerësonte më tej. Nga dokumentet e administruara konstatojmë se Komisioni ka kërkuar dokumentacion për 4 raste të denoncuar dhe për të cilat sërish nuk reflektohet asnjë trajtim dhe vlerësim në vendimin e tij.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, çmon se hetimi i Komisionit ka qenë i mangët apo dhe në disa raste, të adresuar nga denoncimet, ka munguar plotësisht, megjithëse ato mund të kenë elemente që mund të drejtojnë në një vlerësim të kundërt lidhur me aftësitë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Të nderuar anëtarë të Kolegjit!

Si përfundim, Komisioneri Publik çmon se hetimi administrativ i Komisionit dhe provat e administruara për këtë qëllim janë të pamjaftueshme për të konkluduar me besueshmëri në konfirmin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara nga hetimi i Komisionit, konstaton se ky i fundit nuk ka administruar dokumentacion ligjor provues mbi pagimin e detyrimeve tatimore **për shumën totale prej 9.873.623 lekë**, të ardhura këto të cilat kanë shërbyer si burim në krijimin e

¹¹ Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit.

pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Ndërsa lidhur me kriterin e aftësive profesionale, për gjetjet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit, çmojmë se duhej trajtuar lidhur edhe me vlerësimin e gjetjeve të mundshme nga denoncimet e publikut, ku konstatojmë se për disa prej tyre hetimi ka munguar dhe nuk kanë gjetur vlerësim nga ana e Komisionit.

Në këto kushte vlerësojmë se mangësitë e vërejtura në hetimin administrativ të Komisionit, mund dhe duhen të rregullohen nga ana e juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me qëllim konstatimin **nëse** pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe aftësitë profesionale të saj përmbushin kërkesat e vendosura nga neni D dhe E, i aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konfirmohet në detyrë.

Bazuar në nenin F, pika 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenin 59 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në ankim nga ana e Komisionerit Publik të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Darjel SINA
Komisioner Publik